# Përmbajtja

1. Fjala përshëndetëse e Drejtorit Ekzekutiv 3
2. Bordi Menaxhues 4
3. Këshilli Drejtues 5
4. Struktura organizative e Bankës Ekonomike 6
5. Vizioni dhe misioni 7
6. Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë kosovare 9
Produkti i brendshëm bruto (GDP) 10
Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet 11
Inflacioni 12
Tregëtia e jashtme 12
Bujqësia 13
Papunësia 14
Sistemi bankar 15
7. Vështrim mbi afarizimin e Bankës Ekonomike 19
Llogaritë bankare 20
Kreditimi 21
Depozitat 22
Thesari 23
Qarkullimi i pagesave 24
Menaxhimi i riskut kreditor 27
Burimet njerëzore 28
Marketingu 29
8. Raporti i auditorëve të pavarur 32
9. Pasqyrat financiare 40
10. Adresat dhe kontaktet 76

# 1.Fjala përshëndetëse e Drejtorit Ekzekutiv

Viti 2008 ishte vit i ndryshimeve të mëdha në Bankën Ekonomike. Ishte një vit shumë i suksesëshëm i cili bëri që banka të krenohet me rezultatet e arritura.
Depozitat e klientëve brenda vitit 2008 shënuan rritje prej më shumë se 63%, nga 44.5 milionë euro në 72.6 milionë euro, portfolio e kredisë ka pasur rritje prej 65%, nga 34.3 milionë euro në 57 milionë euro, ndërsa asetet e bankës u rritën për 54%, pra nga 56 milionë euro në 86.1 milionë euro. Fitimi i përgjithshëm neto ka qenë 1,013,806.52 euro. Menaxhmenti i bankës, fokusin kryesor gjatë vitit 2008 e ka pasur në plotësimin e vendeve të punës me njerëz adekuat, trajnimin e stafit në fusha të ndryshme, por në veçanti në shitje dhe sjellje me klientë, në mënyrë që t`u ofrojmë klientëve kushte dhe shërbime sa më të mira.

Gjatë vitit 2008 investimet e Bankës Ekonomike janë orientuar në modernizimin e degëve ekzistuese në Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan, si dhe në hapjen e nëndegëve të reja në Podujevë, Klinë, Prizren dhe Vushtrri. Në kuadër të planit për zgjerimin e degëve dhe nëndegëve gjatë vitit 2008 janë hapur gjithsejt 13 degë dhe nëndegë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zgjerimit të rrjetit të bankomatëve me qëllim që klientëve t`u kursejmë kohën për kryerjen e shërbimeve bankare, ku mund të kenë qasje në llogaritë / paratë e tyre 24 orë në ditë.

Rritja e depozitave ka qenë një ndër sfidat më të mëdha të menaxhmentit të bankës, gjë që është realizuar me mjaft sukses, duke e tejkaluar planin për 29 %. Me organizimin e fushatave të ndryshme të kursimeve, të gjitha degët e Bankës Ekonomike, Departamenti i Marketingut dhe Departamenti i Zhvillimit të Biznesit kanë bërë një punë të palodhshme, e cila i është shpërbyler bankës, duke arritur që ta përmbyllim vitin me sukses shumë të lartë dhe duke arritur që Banka Ekonomike tashmë të pozicionohet dhe të jetë bankë konkurente në treg, si dhe të ketë një imazh shumë të mirë.
Gjithashtu portfolio e kredisë ka tejkaluar planin e biznesit për 21 %. Me punën e pandashme të Departamentit të Riskut është arritur që rreziku kreditor të mbahet nën kontroll, ku volumi i kredive në vonesë ka rënë dukshëm dhe kjo është arritur falë analizës së detajuar që u bëhet bizneseve dhe një kontrolle të vazhdueshme nga Departamenti i Riskut. Punë e shkëlqyeshme gjatë vitit 2008, është bërë në automatizimin e sistemit të bankës si dhe sistemit të raportimit, gjë që ka zvogëluar në minimum rrezikun operacional, i cili ka qenë mjaft i lartë.
Numri i punëtorëve është vazhdimisht në rritje. Gjatë vitit që shkoi pothuajse i gjithë stafi është trajnuar dhe intergruar me sukses në ekipën e Bankës Ekonomike.

Numri i punëtorëve me 31 dhjetor 2008 ka mbërri në 267 prej të cilëve 248 me orar të plotë, ndërsa 19 me gjysmë orari. Krahasuar me vitin 2007, në vitin 2008 numri i të punësuarve është rritur për 14.5 %.

Marrë në tërësi, edhe përkundër konkurencës mjaft agresive që ka qenë gjatë vitit 2008 si dhe krizës globale financiare që kaploi botën, ne kemi arritur që ta përmbyllim vitin 2008 me suksese jashtëzakonisht të larta, gjë që tregon përkushtimin e menaxhmentit për zhvillimin afatgjatë të Bankës Ekonomike.
Gjithë këto arritje nuk do të ishin të mundura pa përkrahjen e pandërprerë të aksionarëve të bankës. Dëshirojë t`u shprehi falenderimet e mia të sinqerta për besimin dhe dedikimin që dhanë për arritjen e këtyre rezultateve.

Gjithashtu dua t`u shprehi mirënjohje punëtorëve të bankës për punën, përkushtimin dhe besnikërinë e tyre. Kjo është dëshmuar edhe njëherë që punëtorët janë pasuria jonë më e rëndësishme.



Me respekt,

Valon Lluka
Drejtor Ekzekutiv

# 2. Bordi Menaxhues



Valon **LLUKA**
Drejtor Ekzekutiv

Fisnik **KËPUSKA**
Zëvendësdrejtor Ekzekutiv

## Këshilli Drejtues

| | | | |
|---|---|---|---|
| Hajrullah **ZAITI**<br>Kryetar | Raif **REXHEPI**<br>Zëvendëskryetar | | |
| Hasan **HAJDARI**<br>Anëtar | Xhabir **KAJTAZI**<br>Anëtar | Selim **PACOLLI**<br>Anëtar | Ramë **REXHA**<br>Anëtar |
| Qerim **RAMADANI**<br>Anëtar | Ismet **GJOSHI**<br>Anëtar | Valon **LLUKA**<br>Anëtar, Drejtor Ekzekutiv | |

# 4. Struktura organizative e Bankës Ekonomike



# 5.Vizioni dhe misioni

Banka Ekonomike do të jetë një bankë transparente, e hapur, e orientuar në sigurimin e shërbimeve cilësore për klientët, duke ofruar standarde të larta profesionale.

Misioni ynë do të jetë të jemi ofrues vendas modern shërbimesh bankare e financiare, duke ofruar cilësi e vlerë, nëpërmjet operimit me teknologji të avancuara moderne, kapacitete të larta menaxheriale e performancë të lartë në përmbushjen maksimale të nevojave të klientëve tanë.

Në funksion të arritjes të misionit tonë, ne synojmë të sigurojmë një përdorim racional të burimeve tona të brendshme, si ato teknologjike ashtu edhe ato njerëzore.

Grupi i klientëve tanë, përbëhet si nga individët, të cilët na i besojnë kursimet e tyre dhe përmbushin nevojat individuale, edhe nga kompanitë e biznesit. Klientët e biznesit kryesisht janë kompani të suksseshme të vogla e të mesme, por edhe të mëdha, të cilat kanë nevojë për rritje të mëtejshme.






# 6.Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë kosovare

# 6.Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë kosovare

Deri në fillim të vitit 2008, sidomos në pesë-gjashtë vitet e para nga përfundimi i luftës (qershor 1999), ekonomia kosovare karakterizohet me fazën e rindërtimit të vendit të shkatërruar gjatë luftës,të shtëpive dhe të objekteve të banimit të djegura, të rrugëve dhe urave, ambulancave, shkollave, si dhe zhvillimin e sektorit privat të ekonomisë dhe jashtë ekonomisë, krijimin e sistemit bankar me Bankën Qendrore të Kosovës dhe 7 banka komerciale, fillimin e procesit të privatizimit me intensitet të shtuar në tri vitet e fundit, me investime në sektorin e energjetikës, kryesisht nga donacionet e bashkësisë ndërkombëtare, me mos definimin e statusit të Kosovës, që rezultoi me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik, etj.

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, në bazë të rritjes së ulët të produktit të brendshëm bruto (GDP) për kokë banori ndikoi në rritjen e vazhdueshme të papunësisë dhe moszgjidhjen e statusit të pensionistëve. Edhe në vitin 2008 nuk ka pasur lëvizje të ndjeshme të zhvillimit ekonomik. Prodhimi i brendshëm bruto për kokë banori ishte ndër më të ultit në rajon, ndërsa përqindja e papunësisë ishte më e larta (55-60 %) me tendencë të keqësimit. Mbulesa e importit të mallrave dhe shërbimeve me eksporte në fund të vitit 2008 ishte e ulët ( 10.16 %), për shkak të varësisë së ekonomisë kosovare nga importet,që tregon nivelin e ulët të zhvillimit global dhe struktural të ekonomisë.

# 6.1 Produkti i brendshëm bruto (GDP)

Niveli i ulët i produktit të brendshëm bruto (GDP) për kokë banori është tregues i nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës pas luftës së vitit 1999 e deri në fund të vitit 2008 dhe krahasuar me vendet e rajonit, Kosova është vendi më i pazhvilluar. Niveli i produktit të brendshëm bruto për kokë banori në periudhën pesëvjeçare 2002-2008, ishte më i larti në vitin 2002 (1.288 euro) ndërsa në fund të kuartalit të tretë të vitit 2008 është realizuar në shumën prej 1.759 euro ose për 52.96 % më i lartë se në vitin paraprak.

Realizimi i produktit të brendshëm bruto në Kosovë në këtë nivel është rrjedhim i disa faktorëve kryesorë, e sidomos i mungesës së prodhimit vendor, investimeve të huaja, mospërfundimit të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore e mosaktivizimit të shumë ndërmarrjeve të privatizuara, rënies drastike të donacioneve të bashkësisë ndërkombëtare dhe moszgjidhjes së statusit të Kosovës gjer në fund të vitit 2008.Në formimin e produktit të brendshëm bruto më së shumti kanë ndikuar tre faktorë: importet, asistenca e huaj dhe dërgimi i mjeteve.

Produkti i brendshëm bruto (GDP)

| PËRSHKRIMI / PERIUDHA | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| GDP (në mil. euro) | 2.447 | 2.420 | 2.282 | 2.238 | 2.270 | 2.378 | 3.804 |
| GDP për banorë (në euro) | 1.288 | 1.252 | 1.161 | 1.120 | 1.117 | 1.150 | 1.759 |
| Dërgesat e punëtorëve (në mil.euro) | 341 | 341 | 215 | 281 | 318 | 398 | 536 |
| Ndihma nga jashtë (në mil.euro) | 887 | 688 | 565 | 491 | 465 | 352 | 357 |
| Populsia (në 000) | 1.900 | 1.932 | 1.965 | 1.999 | 2.015 | 2.063 | 2.096 |



*Banka Qendrore e Republikës së Kosovës:"Monthly Statistics Buletins" janar/09*

# 6.2 Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore në fund të vitit 2008 janë realizuar në shumën prej 941.6 milionë euro dhe janë më të larta se në fund të vitit paraprak për 45.2 milionë euro, ose për 5.04 %. Niveli i të ardhurave të përgjithshme buxhetore varet nga niveli i zhvillimit ekonomik të vendit. Të ardhurat e përgjithshme buxhetore, që nga viti 2003 janë realizuar kryesisht nga të hyrat vendore: doganat, TVSH-a, tatimi i paragjykuar, tatimi në të ardhurat e korporatave dhe taksat e tjera. Në strukturën e të ardhurave buxhetore, të ardhurat nga dogana marrin pjesë me 64.2 % në fund të vitit 2008 dhe janë më të larta se në të njejtën periudhë të vitit paraprak për 72.4 milinonë euro, për shkak të importit të lartë.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore në fund të vitit 2008 janë realizuar në shumën prej 943.8 milinonë euro, përkatësisht më shumë se në të njejtën periudhë të vitit të kaluar për 281.1 milinonë euro. Rritja më e lartë e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore se të ardhurat e përgjithshme buxhetore ka rezultuar me deficitin e buxhetit në fund të vitit 2008 në shumën prej: - 2.3 milionë euro.

Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet [2]

| TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME BUXHETORE NGA TAKSAT: | 444.4 | 536.4 | 550.1 | 559.6 | 621.1 | 712.3 | 804.5 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| - doganat | 364.5 | 428.3 | 436.0 | 436.5 | 457.1 | 531.8 | 604.2 |
| - taksa tjera | 79.9 | 108.1 | 114.1 | 123.1 | 164.0 | 180.5 | 180.5 |
| Të ardhurat tjera | 91.3 | 93.9 | 84.7 | 81.9 | 92.1 | 184.1 | 137.1 |
| Gjithsej: | 537.7 | 630.3 | 634.8 | 641.5 | 713.2 | 896.4 | 941.6 |
| Shpenzimet e përgjithshme | 428.6 | 567.7 | 769.4 | 702.4 | 635.7 | 662.7 | 943.8 |
| Suficiti / deficiti | 107.1 | 62.6 | -134.6 | -60.9 | 77.5 | 233.7 | -2.3 |



[2] *Banka Qendrore e Republikës së Kosovës:"Monthly Statistics Buletins" janar/09*

## 6.3 Inflacioni

Inflacioni, nëpërmes çmimeve me pakicë, ka shënuar rritje të ulët, nga viti 2002, kur ka filluar të llogaritet inflacioni pas luftës së vitit 1999. Rritja më e lartë është shënuar në fund të vitit 2003 për 3.7%,ndërsa në fund të vitit 2005 është për 2.8% ,në fund të vitit 2006 për 3.9 % dhe në fund të vitit 2007 për 10.6% , kurse në fund të vitit 2008 për 10.9 % .[3]

Rritja e inflacionit ishte më tepër rezultat i inflacionit të importuar, për shkak të importit shumë të lartë të mallrave dhe shërbimeve.

## 6.4 Tregtia e jashtme

Gjatë vitit 2008 kanë vazhduar aktivitetet më të mëdha në import se në export të mallrave dhe shërbimeve.[4] Shuma e përgjithshme e importit prej 1,927.9 milionë euro në fund të vitit 2008 ishte më e lartë se në fund të vitit 2007 për 352.3 milionë euro, ose për 22.36 %. Ndërsa, shuma e përgjithshme e eksportit në fund të vitit 2008, prej 195.9 milionë euro ishte më e lartë se në fund të vitit 2007 për 49.3 milionë euro, ose për 33.6%.

Për shkak të rritjes së eksportit në fund të vitit 2008,është rritur edhe mbulesa e importit me eksport nga 4.1% në fund të vitit 2005, në 6.0% në fund të vitit 2006 , në fund të vitit 2007 në 9.3%, dhe në fund të vitit 2008 në 10.16%, ndërsa deficiti i bilancit tregtar nga 1,131.1 milionë euro në 1,235.3 milionë euro në 2006, ndërsa në 1,429.0 milionë euro në fund të vitit 2007 dhe në 1,732.0 milionë euro në fund të vitit 2008.

| PARTNERËT KRYESORË TREGTAR TË IMPORTIT NË FUND TË VITIT 2008 ME 76.73% PJESËMARRJE, JANË: | |
|---|---|
| **Unioni Europian** | 36.2% |
| **Maqedonia** | 18.1% |
| **Serbia** | 10.9% |
| **Turqia** | 6.6% |
| **Shqipëria** | 3.2% |
| **Zvicra** | 1.7% |



[3]Banka Qendrore e Republikës së Kosovës:"Monthly Statistics Buletins" janar/09
[4]Banka Qendrore e Republikës së Kosovës:"Monthly Statistics Buletins" janar/09

| PARTNERËT KRYESORË TREGTAR TË EKSPORTIT ME 78.5% PJESËMARRJE JANË: | |
|---|---|
| **Unioni Europian** | 47.8% |
| **Shqipëria** | 10.8% |
| **Serbia** | 5.1% |
| **Maqedonia** | 9.9% |
| **Zvicra** | 3.5% |
| **Turqia** | 1.6% |

# Bujqësia

Toka bujqësore përfshinë 53% të sipërfaqës së përgjithshme të tokës së Kosovës. Shumica e tokës bujqësore është në pronësi private (80%), duke siguruar ekzistencë për familjet. Megjithëse sektori i bujqësisë në përgjithësi karakterizohet me ferma të vogla, me produktivitet të ulët, dhe me mungesë të shërbimeve këshilldhënëse. Bujqësia kontribuon rreth 25% të produktit të brendshëm bruto (GDP) të përgjithshëm të Kosovës.

Bujqësia është sektori më i madh në Kosovë që krijon vende pune, duke ju siguruar punë rreth 25% deri 30% të popullatës, kryesisht në baza joformale. Sektori i bujqësisë gjithashtu numëron 16% të vlerës së eksportit të përgjithshëm dhe mbetet një kreator i rëndësishëm i pasurisë kombëtare, megjithëse Kosova është ende importues i shumë produkteve bujqësore që përbën  24% të të gjitha importeve.

# 6.5 Papunësia

Papunësia është në rritje të vazhdueshme që nga viti 2000, kur evidentohen 208.074 të pa punë, ndërkaq që ky numër në fund të vitit 2007 ka arritur në 334.595, që është më shumë për 60.8%, ndërsa në fund të vitit 2008 ka arritur në 335.942 [5]

Në rritjen e papunësisë ka ndikuar niveli i ulët i zhvillimit ekonomik.

| PERIUDHA | Numri i të papunëve | Femra % | Edukim elementar % | Edukim sekondar % | Edukim universitar % |
|---|---|---|---|---|---|
| 2002 | 257.505 | 44.5 | 61.5 | 36.2 | 2.2 |
| 2003 | 282.305 | 45.4 | 63.0 | 35.3 | 1.7 |
| 2004 | 301.982 | 45.7 | 63.4 | 35.1 | 1.5 |
| 2005 | 319.721 | 46.3 | 63.5 | 35.0 | 1.5 |
| 2006 | 326.026 | 46.7 | 63.7 | 34.8 | 1.5 |
| 2007 | 334.595 | 46.8 | 63.9 | 34.7 | 1.5 |
| 2008 | 335.942 | 47.1 | 63.9 | 34.6 | 1.5 |

Pjesëmarrja e femrave në numrin e përgjithshëm të papunësuarve është rritur nga 44.5% në vitin 2002, në 47.1 % në fund të vitit 2008. Ndërsa, sipas kualifikimit shkollor, pjesëmarrje më të lartë ka shënuar edukimi elementar me 63.9%, kurse më të ulët edukimi universitar me 1.5% në fund të vitit 2008.



[5] *Banka Qendrore e Republikës së Kosovës:"Monthly Statistics Buletins" janar/09*

# 6.6 Sistemi bankar dhe financat

Sistemi bankar i Kosovës, përbëhet prej 7 bankave komerciale të nivelit të dytë dhe 288 degëve e nëndegëve[6] në tërë territorin e Kosovës. Të gjitha bankat komerciale selinë e kanë në Prishtinë, ndërsa degët e tyre janë të hapura në shtatë qëndrat kryesore të Kosovës:Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Ferizaj.

Bankat me degët dhe nëndegët e tyre janë të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në mbështetje të Rregullores për Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave të vitit 1999.
Depozitat dhe kreditë e bankave komerciale në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme: [7]

(në '000 euro)

| PËRSHKRIMI /PERIUDHA | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Depozita | 427.194 | 514.045 | 692.296 | 838.584 | 923.260 | 1,111.234 | 1,424.684 |
| Kredi | 86.498 | 232.773 | 373.668 | 492.079 | 576.912 | 819.506 | 1,087.991 |
| % kredi/depozita | 20,2 | 45,3 | 53,9 | 58,7 | 62,5 | 73,75 | 76,37 |
| Fitimi neto | 2.716 | 6.801 | 10.349 | 13.229 | 19.297 | 33,780 | 32,075 |



[6] *Banka Qendrore e Republikës së Kosovës:"Monthly Statistics Buletins" janar/09*

[7] *Shenimet e publikuara të bankave komerciale në gazetat e përditshme*

Shuma e përgjithshme e depozitave në fund të vitit 2008 është më e lartë për 233.5% në krahasim me vitin 2002 dhe për 28.21% në krahasim me vitin 2007. Rritja e depozitave prej vitit në vit është rrjedhim i rritjes së besimit të klientëve (kursimtarëve) në bankat komerciale, si rezultat i likuiditetit të lartë dhe të qëndrueshëm bankar.

Depozitat e afatizuara në fund të vitit 2008 kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2004, 2005 dhe 2006, duke ndikuar në krijimin e kushteve për një politikë më të qëndrueshme kreditore.

(në 000 euro)

| DEPOZITA | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|---|---|---|---|---|---|
| Llogari rrjedhëse | 278.697 | 296.607 | 319.008 | 284.809 | 365.147 |
| Depozita të afatizuara | 413.599 | 541.977 | 604.252 | 826.425 | 1,059.537 |
| Gjithsej: | 692.296 | 838.584 | 923.260 | 1,111.234 | 1,424.684 |

Për të ndikuar në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit, bankat komerciale që nga viti 2003 e rritën përkrahjen financiare të aktiviteteve ekonomike nëpërmes të kreditimit të bizneseve të vogla, të mesme dhe personave individualë (fizikë) për destinime të ndryshme.

Pjesëmarrja e shumës së përgjithshme të kredive (portofolio neto) në shumën e depozitave është rritur nga 20.2% në fund të vitit 2002 në 76.37% në fund të vitit 2008. Ndërsa shuma e përgjithshme e kredive është rritur për 1.157 % (mbi njëmbëdhjetë herë) në fund të vitit 2008, në krahasim me vitin 2002 dhe për 847.4% në krahasim me vitin 2007.

| KREDITË NË FUND TË VAITIT 2008 JANË SHFRYTËZUAR ME KËTË STRUKTURË BRENDA EKONOMISË: | | | |
|---|---|---|---|
| **tregti** | **704.800.000 euro** | ose | **64.9%** |
| **industri** | **160.200.000 euro** | ose | **14.7%** |
| **bujqësi** | **37.400.000 euro** | ose | **3.4%** |
| **të tjera** | **185.591.000 euro** | ose | **17.0%** |
| **GJITHSEJ:** | **1.087.991.000 euro** | ose | **100 %** |

Në kuadër të ekonomisë, bujqësia shfrytëzoi më së paku kredi edhe pse ka resurse për një zhvillim shumë më të lartë. Në zhvillimin më të lartë të bujqësisë mund të ndikohet me ndërmarrjen e masave stimulative: politika fiskale, kredi me afatë më të gjatë të shfrytëzimit dhe normë më të ulët të interesit, politika doganore, etj. Ndërsa, shfrytëzimi i ulët i kredive në industri rezultoi me mosinteresimin e investitorëve të huaj për shkak të mos zgjidhjes së statusit të Kosovës, përkatësisht garantimit të investimeve.

Rritja e afarizmit të bankave komerciale (niveli i kredive dhe shërbimet tjera) në vitin 2008 rezultoi me realizimin e fitimit neto në shumën prej 32.1 milionë euro. Vetëm 2 banka realizuan humbje, të cilat startuan në fund të vitit 2007.

Mjetet e lira të depozitave, pas shfrytëzimit për kredi dhe sigurimin e likuiditetit minimal të bankave, bankat komerciale i kanë plasuar në bankat korrespodente me normë më të ulët të interesit.




# 7. Vështrim mbi afarizimin e Bankës Ekonomike gjatë vitit 2008

# 7. Vështrim mbi afarizimin e Bankës Ekonomike gjatë vitit 2008

Banka Ekonomike, në fund të vitit 2008, ka realizuar shumën e aktivës me 86.1 milionë euro dhe shumën e përgjithshme të bilancit me 92.6 milionë euro, duke përfshirë zërat jashtëbilancorë.Në krahasim me vitin 2007, shuma e përgjithshme e aktivës ishte më e lartë për 53.8% dhe shuma e bilancit për 51.4%.
Fitimi i përgjithshëm neto në vitin 2008 ishte 1.013.806 euro.
Ecuritë e realizuara afariste të Bankës Ekonomike në fund të vitit 2008 (numri i llogarive të klientëve, depozitat dhe kreditë) ishin mbi nivelin e vitit paraprak.

Tashmë Banka Ekonomike numron 37 degë në mbarë territorin e Kosovës, pra është prezente kudo. Rrjeti i bankomateve (ATM've) është në rritje e sipër. Në fund të vitit 2008, Banka Ekonomike ka pasur 16 ATM'a në funksion, të cilët kanë sherbyer që klientët të kenë qasje 24 orë në llogarinë e tyre.
Ecuritë e realizuara afariste të Bankës Ekonomike në fund të vitit 2008 (numri i llogarive të klientëve, depozitat dhe kreditë) ishin mbi nivelin e vitit paraprak.

(Asetet në milionë euro.)



# 7.1 Numri i llogarive të klientëve

Numri i llogarive të klientëve të Bankës Ekonomike ka shënuar rritje të vazhdueshme prej viti në vit dhe në fund të vitit 2008 është rritur në 54.054, me këtë strukturë:

| PËRSHKRIMI VITI | 2003 | % | 2004 | % | 2005 | % | 2006 | % | 2007 | % | 2008 | % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Persona juridikë | 1.660 | 8.6 | 2.466 | 8.9 | 3.085 | 9.1 | 3.644 | 8.7 | 4.119 | 8.7 | | |
| Persona fizikë | 17.589 | 91.4 | 25.743 | 91.1 | 31.020 | 90.9 | 38.421 | 91.3 | 43.380 | 91.3 | | |
| Gjithsej: | 19.249 | 100 | 27.809 | 100 | 34.105 | 100 | 42.065 | 100 | 47.499 | 100 | 54.054 | 100 |

Numri i përgjithshëm i llogarive të klientëve në fund të vitit 2008 është rritur për 13.8% në krahasim me vitin e kaluar.

NUMRI I KLIENTËVE




Llogaritë e klientëve të hapura në Bankën Ekonomike janë të personave juridikë dhe individualë, vendas dhe të huaj.

# 7.2 Kreditimi

Banka Ekonomike ka arritur sukses dhe rritje të konsiderushme në finansimet e sektorëve të bizneseve të vogla, bizneseve të mëdha dhe të personave fizikë. Numri i kredive është rritur vazhdimisht, gjë që tregon se banka në fokus të veçantë i ka vënë sektoret e kredive të vogla dhe ato të personave fizikë.




Portfolio e kredisë ka shënuar rritje mjaft të lartë gjatë vitit 2008. Shuma e protofolios së kredisë përfshirë mbitërheqjet dhe garancionet bankare kapë shumën prej 57 milionë euro apo rritje prej 65% krahasim me vitin 2007.



# 7.3 Depozitat

Banka Ekonomike në fund të vitit 2008 realizoi shumën e përgjithshme të depozitave prej 72.6 milionë euro, për 63% më shumë se në vitin e kaluar.




**Struktura e depozitave është si më poshtë:**

(në '000 euro)

| PËRSHKRIMI VITI | 2003 | % | 2004 | % | 2005 | % | 2006 | % | 2007 | % | 2008 | % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Depozita me afat | 12.778 | 59.3 | 21.414 | 68.5 | 27.695 | 71.4 | 29.748 | 68.7 | 31.891 | 71.7 | 52.944 | 73.0 |
| Depozita pa afat | 8.783 | 40.7 | 9.865 | 31.5 | 11.066 | 28.6 | 13.540 | 31.3 | 12.614 | 28.3 | 19.654 | 27.0 |
| Gjithsej: | 21.561 | 100 | 31.279 | 100 | 38.861 | 100 | 43.288 | 100 | 44.505 | 100 | 72.599 | 100 |

Rritja e pjesëmarrjes së depozitave me afat në shumën e përgjithshme të depozitave, prej viti në vit, ka rezultuar me forcimin e besimit të kursimtarëve në Bankën Ekonomike dhe krijimin e kushteve për një politikë stabile kreditore.

Ndërsa, rritja e shumës së përgjithshme të depozitave ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në shumën e përgjithshme të depozitave në nivel të bankave komerciale në Kosovë nga 4.01% sa ishte në vitin 2007, në 5.1% në fund të vitit 2008.

# 7.4 Thesari

Njësia e Thesarit është e përqëndruar në këmbimet me valutat e huaja, menaxhimin e likuiditetit, plasimin e fondeve në bankat korrespodente, menaxhimin e riskut të normës së interesit etj.
Të hyrat nga këmbimet e huaja dhe ndryshimet e kursit kanë tejkaluar të hyrat e vitit 2007 për 120%. Këmbimet e huaja kanë pasë edhe një ndikim në të hyrat tek komisionet e transferave të jashtme duke ju ofruar mundësi klientëve tanë që të kryejnë obligimet financiare në të gjitha valutat.
Gjatë vitit 2008 kemi bërë hapjen e llogarive bankare në 3 banka të reja korrespodente Deutsche Bank, Unicredit Group-Bank Austria dhe NLB Slovenia. Kjo ka ndihmuar në zhvillimin e bankës sonë duke ju ofruar mundësi të ndryshme dhe shërbim më të shpejtë dhe më të lirë klientëve tanë.

Vëllimin kryesor në valutat e huaja banka ka në valutën e USD dhe CHF. Duke pasur parasysh që ndryshimet e kursit kanë ndikim në këto valuta, kryesisht në asetet e bankës, rreziku ndaj valutës është monitoruar në baza ditore dhe ka mirëmbajtur pozicionet e valutave të huaja nën 10%.
Procedurat e likuiditetit të bankës janë krijuar me qëllim që të bëhet menaxhimi për një afat më të gjatë, duke u nisur prej 1-30 ditë deri mbi 1 vit. Struktura e menaxhimit të rrezikut ndaj likuditetit është e përcaktuar që të identifikohen, maten dhe menaxhohen pozicionet e rrezikut të likuiditetit. Mënyra jonë e menaxhimit fillon në baza ditore duke menaxhuar pagesat, parashikimin e rrjedhës së parasë së gatshme dhe parashikimin afatgjatë.

Njësia  e Thesarit është përgjegjëse për menaxhimin e likuiditetit të bankës. Banka Ekonomike gjatë vitit 2008 ka qenë mjaft likuide.



# 7.5 Qarkullimi i pagesave

Qarkullimi i pagesave vendore në kuadër të Departamentit të Operativës gjatë vitit 2008 ka shënuar rritje në qarkullimin e pagesave kliring.

Transferet vendore kanë shënuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2008. Shuma totale e transfereve përmes sistemit të kliringut ka qenë 231.867.339,00 euro, ku nga këto transfere kliring hyrëse kanë qenë 111.639.650,00 euro apo krahasuar me vitin 2007 me një rritje prej 78.67%, ndërsa transferet kliring dalëse kapin shumën prej 120.228.689,00 euro apo rritje në krahasim me vitin 2007 me një rritje prej 48.40%.

TRANSFERET VENDORE




Marrë në tërësi transferet ndërkombëtare gjatë vitit 2008 kanë shënuar rritje shumë të kënaqshme krahasuar me vitin 2007.

Vlera e përgjithshme e transfereve ndërkombëtare në fund të vitit 2008 ka qenë 152.522.818.00 euro, ku nga këto, transfere ndërkombëtare hyrëse kanë qenë 77.205.076,00 euro apo krahasuar me vitin 2007 me rritje prej 16.10% ndërsa ato dalëse kanë qenë 75.328.742,00 euro apo krahasuar me vitin 2007 me rritje prej 17.35%.

## TRANSFERET NDËRKOMBËTARE




**Realizimi i këtyre transfereve mundësohet përmes bankave korrespodente:**

- LHB Iternacionale Handelsbank,Frankfurt,Gjermani
- RZB Raiffaisen Zentralbank Oesterich AG,Vjenë, Austri
- BASH Banka Amerikane e Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri
- Deutsche Bank AG, Frankfurt Gjermani, dhe New York, USA
- BANK AUSTRIA, Unicredit Group, Austri
- NLB Slovenia, Slloveni



## GARANCIONET

Garancionet gjatë vitit 2008 kanë shënuar rritje, si nga vlera e tyre ashtu edhe në numër. Prandaj krahasuar me vitin 2007 kemi ngritje për 14.30%.

### GARANCIONET BANKARE



# 7.6 Menaxhimi i riskut kreditor

Gjatë vitit 2008 është punuar shumë për përmirësimin e kualitetit të portfolios së kredisë si dhe për menaxhimin e kësaj portfolio.

Edhe pse rritja e portfolios së kredisë ka qenë shumë e lartë, me kujdesin më të madh kemi arritur që kjo portfolio të ketë kualitet mjaft të mirë.
Janë mbajtur trajnime kohë pas kohe për të gjithë analistët kreditorë, në mënyrë që të jenë sa më të përgatitur për analiza financiare.
Gjithashtu është arritur që sistemi i raportimit lidhur me kredi të jetë i automatizuar, moduli i kreditimit tashmë është në funksion dhe çdo gjë është rregulluar sipas kërkesave të Bankës Qëndrore dhe auditorit të jashtëm.

Është arritur që kreditë e vjetra të regjistrohen në modulin e ri dhe nga muaji janar 2009 banka ka sistem komplet të automatizuar të kredive.
Njësia për kreditë problematike që nga fillimi ka qenë shumë aktive dhe qëllimi kryesor i saj është vizita dhe presioni ndaj klientëve që janë në vonesë, klientëve problematikë dhe atyre të paditur.

Janë realizuar shumë vizita klientëve në fjalë të cilat kanë rezultuar me sukses në arkëtimin e mjeteve nëpërmjet presionit të vazhdueshëm ndaj tyre si dhe në vetëdijsimin e tyre për mostolerimin e vonesave.

# 7.7 Burimet njerëzore

Departamenti i Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2008 kryesisht është përqëndruar në trajnimin e punëtorëve dhe në motivimin e tyre, si dhe ka mbikëqyrur zbatimin e procedurave të lëshuara nga ky departament një vit më parë.

Politikat dhe procedurat e burimeve njerëzore kanë hyrë në funksion të plotë gjatë vitit 2008.
Duke pasur parasysh që kontakti i drejtpërdrejtë me klientin është shumë i rëndësishëm, është përpiluar edhe Kodi i Veshjes sipas të cilit të gjithë punëtorët që punojnë drejtpërdrejt me klientë në shitjen e produkteve dhe shërbimeve bankare, janë pajisur me uniformë unike të bankës.

Numri i punëtorëve me 31 dhjetor 2008 ka qenë 267 punëtorë prej të cilëve 248 me orar të plotë ndërsa 19 me gjysmë orari. Krahasuar me vitin 2007, në vitin 2008 numri i të punësuarve është rritur për 14.5 %.
Gjatë vitit 2008, angazhimi më i madh i Departamentit të Burimeve Njerëzore ka qenë në trajnimin e stafit për lëmenjt më të rëndësishëm të sistemit bankar e sidomos për shitjen dhe mënyrën e qasjes ndaj klientit.



# 7.8 Marketingu

Sot marketingu po bëhet pjesë e pandashme në afarizimin e suksesshëm dhe prezantimin e Bankës Ekonomike, duke ndikuar në krijimin e një imazhi pozitiv në sektorin bankar. Krijimi i identitetit të bankës , duke filluar nga veshja e pesonelit të bankës, web faqja identifikuese, fushatat  e ndryshme, si dhe  materialet e ndryshme propaganduese, kanë pasë një ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në krijimin e një marrëdhënje reciproke të besueshme me klientët e vet e gjithashtu edhe me shoqërinë në tërësi .

Gjatë vitit 2008 investimet e Bankës Ekonomike janë orientuar në modernizimin e degëve ekzistuese në Prishtinë, Gjakovë, Prizren,  Mitrovicë, Gjilan, si dhe në hapjen e nëndegëve të reja në Podujevë, Klinë, Prizren dhe Vushtrri. Në kuadër të planit për zgjerimin e degëve dhe  nëndegëve gjatë vitit 2008 janë hapur gjithësejt 13 degë dhe nëndegë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zgjerimit të rrjetit të bankomatëve me qëllim që klientëve të saj t'u kursejë kohën për kryerjen e shërbimëve bankare, ku mund të kenë qasje në llogaritë / paratë e tyre 24 orë në ditë .
Qëllimi themelor i marketingut të Bankës Ekonomike është identifikimi i nevojave dhe kërkesave, si individuale ashtu edhe shoqërore , që nënkupton plotësimin e tyre duke realizuar profitin e caktuar.






# Pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit

## PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor të vitit 2008

# Përmbajtja


| | |
|---|---|
| Raporti i auditorit të pavarur | 32 |
| Bilanci i gjendjes | 34 |
| Pasqyra e të ardhurave | 36 |
| Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar | 37 |
| Pasqyra e rrjedhës së parasë | 38 |
| Shënimet në pasqyrat financiare | 40 |

# Raporti i auditorit të pavarur

KPMG Albanian Sh.p.k Kosovo Branch
Rruga Sulejman Vokshi nr.14
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

Telephone: +381 38 246 771
Telefax: +381 38 246 772
E-mail: al-kosovo@kpmg.com
Web: www.kpmg.al

**Për aksionarët e Bankës Ekonomike Sh.a.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Ekonomike Sh.a. ("Banka") ku përfshihen bilanci i gjendjes deri më 31 dhjetor 2008 si dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për fund vitin 2008, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënime të tjera. Pasqyrat financiare të bankës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2007, janë audituar nga auditorë të tjerë, raporti i të cilëve është lëshuar më 18 qershor 2008, që kanë shprehur opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare për arsye të kufizimit të fushëveprimit lidhur me njohjen e provizionimit të kredive në përputhshmëri me IAS 39, të hyrat e komisioneve dhe të tarifave nga aktivitetet e kreditimit.

**Përgjegjësit e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e pasqyrave financiare në përputhshmëri me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës. Kjo përgjegjësi përfshin: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollave relevante për përpilimin dhe prezantimin e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë gabime materiale, nga cilado arsye, e gabimit me qëllim apo pa qëllim, përzgjedhja dhe aplikimi i politikave të duhura të kontabilitetit, si dhe bërja e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

**Përgjegjësitë e auditorit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim lidhur me pasqyrat financiare bazuar në auditimin e bërë.
Përveç se si është përshkruar në paragrafin e mësipërm për opinion të kualifikuar, ne kemi kryer auditimin në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto Standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin në mënyrë që të përfitojmë një siguri racionale nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin performimin e procedurave për marrjen e dëshmive audituese lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyart financiare. Procedurat e selektuara për auditim varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut për gabime materiale në pasqyrat financiare, të bëra me apo pa qëllim. Në vlerësimin e rreziqeve, auditori merr parasysh kontrollet e brendshme relevante në përpilimin dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare, në mënyrë që të dizajnoj proceduart e auditimit që të jenë ato të duhura në rrethana të caktuara, por jo për të shprehur një mendim lidhur me efektivitetin e kontrolleve të brendshme të bankës. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e politikave të duhura të kontabilitetit të përdorura si dhe aryeshmërinë e vlerësimit kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin dhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të ofruar baza për opinionin tonë.

**Bazat e opinionionit të kualifikuar**

Siç është përshkruar në notë 3 (c) të pasqyrave financiare, banka njeh të hyrat nga tarifat dhe komisionet, aktivitetet kredituese në baza të parasë së gatshme për shkak të limiteve në sistemin e teknologjisë informative. Që nga muaji gusht i vitit 2008, këto të hyra nga tarifat dhe komisionet si pjesë integrale e normës efektive të interesit janë të përfshira në matjen e normës efektive të interesit.
Të hyrat nga tarifat dhe komisonet prej 245 mijë euro në vitin që përfundon më 31 dhjetor 2008(2007:euro 407 mijë) paraqesin tarifat bazë të kredive, të cilat janë në përputhje me IAS 18 "Të ardhurat" dhe së bashku me shpenzimet direkte, duhet të shtyhen dhe njihen si korrigjime të normës së interesit efektiv të instrumentit përkatës. Si rezultat i kësaj më lartë dhe në mungesë të kalkulimeve adekuate nga banka për shumat e këtyre tarifave për tu shtyrë në vitet e ardhshme, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë shumën nga cila kreditë dhe avancet ndaj klientëve si me 31 dhjetor 2008 dhe 2007 dhe të hyrat nga tarifat dhe komisionet për vitet që kanë përfunduar janë mbiçmuar ose nënvlerësuar.

**Opinioni i kualifikuar**

Në opinionin tonë, përveç efekteve të rregullimeve të tilla, nëse ka ndonjë, që mund të jenë gjetur që janë të nevojshme për të bindur vetën tonë, për çështjet e treguara në paragrafin e mësipërm, pasqyart financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të bankës si më 31 dhjetor 2008, dhe përformancën financiare si dhe rrjedhjen e parasë për vitin e përfunduar në përputhshmëri me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës

KPMG Albania Sh.p.k Kosovo Branch

KPMG Albanian Sh.p.k - Kosovo Branch
Prishtina

23 Prill 2009

# Bilanci i gjendjes për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2008

(në '000 euro)

| PASURIA | Nota | 2008 | 2007 |
|---|---|---|---|
| Paraja në dorë dhe banka | 4 | 26,031 | 19,251 |
| Balancat me AQBK-në | 5 | 3,711 | 3,628 |
| Kreditë e dhëna klientëve | 6 | 53,331 | 31,016 |
| Patundshmëritë,impiantet dhe paisjet | 7 | 1,688 | 1,401 |
| Pasuria e paprekshme | 8 | 83 | 87 |
| Parapagimet për tatimin nga të hyrat e Korporatës | 18 | 128 | 125 |
| Pasuria tjetër | 9 | 1,145 | 495 |
| | | | |
| **Gjithsej pasuria** | | **86,117** | **56,003** |
| **Detyrimet dhe kapitali aksionar** | | | |
| **Detyrimet** | | | |
| Depozitat e klientëve | 11 | 73,671 | 45,008 |
| Detyrimi në tatimin për të hyrat e korporatës | 18 | 283 | - |
| Të hyrat e shtyra | 10 | 156 | - |
| Llogaritë e pagushme | 12 | 127 | 129 |
| | | | |
| **Gjithsej detyrimet** | | **74,237** | **45,137** |

(në '000 euro)

| PASURIA | Nota | 2008 | 2007 |
|---|---|---|---|
| **Kapitali aksionar** | | | |
| Kapitali aksionar | 13 | 10,764 | 10,764 |
| Rezerva përgjithshme e riskut | 14 | 102 | 102 |
| Fitimi i akumuluar | | 1,014 | 18 |
| | | | |
| **Gjithsej kapitali aksionar** | | **11,880** | **10,866** |
| **Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar** | | **86,117** | **56,003** |

Pasqyrat Financiare prej faqes 1 deri në 35 janë autorizuar për lëshim nga Bordi i Drejtorëve i Bankës Ekonomike Sh.a.më 31 mars 2009 dhe janë nënshkruar nga ata.

Z.Valon **Lluka**
Drejtori Ekzekutiv

Znj.Syzane **Kaçaniku**
Drejtoreshë Financiare



Shënimet nga faqja 40 deri 75 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare

# Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2008

(në '000 euro)

| TË HYRAT NGA INTERESI: | Nota | 2008 | 2007 |
|---|---|---|---|
| Nga kreditë e dhëna klientëve | | 5,210 | 3,119 |
| Nga depozitat dhe balancat me bankat | | 627 | 792 |
| **Gjithsej të hyrat nga interesi** | | **5,837** | **3,911** |
| Shpenzimet e interesit në detyrimet nga kostoja e amortizimit | | (1,873) | (1,181) |
| **Neto të hyrat nga interesi** | | **3,964** | **2,730** |
| Të hyrat nga komisionet dhe tarifat | 15 | 1,556 | 1,367 |
| Shpenzimet nga komisionet dhe tarifat | | (138) | (106) |
| **Të hyrat neto nga komisionet dhe tarifat** | | **1,418** | **1,261** |
| Të hyrat tjera operuese | 16 | 568 | 709 |
| Humbjet neto nga valutat e huaja | | 94 | (77) |
| **Gjithsej të hyrat** | | **6,044** | **4,623** |
| Shpenzimet e tjera operuese | 17 | (3,762) | (2,910) |
| Provizionimi për humbjet nga kreditë | 6 | (980) | (1,689) |
| **Gjithsej shpenzimet operuese** | | **(4,742)** | **(4,599)** |
| **Fitimi para tatimit të hyrave** | | **1,302** | **24** |
| Shpenzimet e tatimit të hyrave | 18 | (288) | (6) |
| **Fitimi neto per vitin** | | **1,014** | **18** |



Shënimet nga faqja 40 deri 75 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare

# Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2008

(në '000 euro)

| | Kapitali aksionar | Rezerva e përgjithshme e rrezikut | Fitimi i mbajtur | Gjithsej kapitali aksionar |
|---|---|---|---|---|
| **Balanca me 1 janar 2007** | **4,725** | **102** | **1,793** | **6,620** |
| Kapitalizmi i fitimit (note 13) | 1,793 | - | (1,793) | - |
| Rritje ne kapitalin aksionar | 4,228 | - | - | 4,228 |
| Neto fitimi i vitit | | - | 18 | 18 |
| **Balance me 31 dhjetor 2007** | **10,746** | **102** | **18** | **10,866** |
| Kapitalizmi i fitimit (note 13) | 18 | - | (18) | - |
| Neto fitimi i vitit | - | - | 1,014 | 1,014 |
| **Balance me 31 dhjetor 2008** | **10,764** | **102** | **1,014** | **11,880** |

# Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2008

(në '000 euro)

| | Nota | 2008 | 2007 |
|---|---|---|---|
| **Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operuese** | | | |
| **Fitimi për vitin** | | 1,302 | 24 |
| Rregullimet për njësitë jo-kesh: | | | |
| Zhvlerësimi | 7 | 376 | 291 |
| Amortizimi | 8 | 29 | 18 |
| Humbjet neto në kredi dhe avance | 6 | 980 | 1,689 |
| Humbjet nga heqjet prej përdorimit të paisjeve dhe | | 30 | - |
| Shpenzimet e interesit | | 1,873 | 1,181 |
| Të hyrat nga interesi | | (5,837) | (3,911) |
| | | **(1,247)** | **(708)** |
| Ndryshimet në balancat e kufizuara me BQK | | (83) | 701 |
| Rritjet në kredi dhe avance për klientë | | (23,295) | (11,565) |
| Ndryshimet në pasurinë tjetër | | (653) | (109) |
| Rritjet në depozita nga klientët | | 28,663 | 1,095 |
| Rritjet/zvogëlimet në detyrimet tjera | | 281 | - |
| Ndryshimet në të hyrat e shtyra | | 156 | 23 |
| | | **3,822** | **(10,563)** |
| Tatimi në të hyra i paguar | | (283) | (213) |
| Interesi i paguar | | (1,873) | (1,185) |
| **Neto kesh-i nga aktivitetet operuese** | | **1,666** | **(11,961)** |

(në '000 euro)

| RRJEDHJA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTIVE | Nota | 2008 | 2007 |
|---|---|---|---|
| Të hyrat nga shitja e pasurisë | | - | 10 |
| Blerjet e pasurisë dhe paisjeve | 8 | (676) | (238) |
| Interesi i arkëtuar | | 5,772 | 3,915 |
| **Neto paraja nga aktivitetet investive** | | **5,096** | **3,687** |
| **Rrjedhja e parasë nga aktivitet financuese** | | | |
| Të hyrat nga lejimi i kapitalit | | 18 | 4,228 |
| **Neto paraja nga aktivitetet financuese** | | **18** | **4,228** |
| **Neto rritjet në para dhe ekuivalentët e parëse** | | | |
| | | 6,780 | (4,046) |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 1 janar 2007 | | 19,251 | 23,297 |
| | | | |
| **Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 31 dhjetor** | 4 | **26,031** | **19,251** |



Shënimet nga faqja 40 deri 75 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare

(shumat në '000 euro, përveç nëse ceken ndryshe)

**1. Të përgjithshme**

Në përputhshmëri me rregullorët e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), Banka Ekonomike Sh.a. Prishtinë ("Banka") morri licencën për zhvillimin e aktivitetit bankar më 28 maj 2001 dhe filloi operimin e saj më 5 qershor 2001. Zyra qendrore e bankës gjendet në Rr. Migjeni Nr.1, Prishtinë, Kosovë. Banka operon njëkohësisht si bankë tregtare dhe kursimi për të gjitha kategoritë e klientëve, përmes rrjetit të saj prej 7 degësh të shtrira në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

**2. Baza për përpilim**

Banka mirëmban librat kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhshmëri me koston historike dhe rregullat kontabël të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK" rregulloret) që janë të aplikueshme për bankat. Rregulloret e BQK-së janë të bazuara në vendimet legale relevante që definojnë aplikimin e obligueshëm të Standardeve të Raportimit Financiar ("IFRS") në Kosovë, por rregulloret e BQK-së gjithashtu kërkojnë në mënyrë specifike aplikimin e trajtimeve kontabël që nuk janë në përputhshmëri me kërkesat e IFRS. Këto pasqyra duhet të lexohen (interpretohen) si të përgatitura në përputhshmëri me standardet e kontabilitetit dhe rregulloret që mbizotërojnë në territorin e Kosovës që janë shpalosur në politikat kryesore të kontabilitetit në Notën 3 më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhshmëri me "BQK" Rregulloret, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe parashikime që afektojnë shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, shpalosje të pasurive dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare, dhe shumën e tyre të raportuar të hyrave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Edhe pse këto vlerësime janë të bazuara në njohuritë më të mira të menaxhmentit për ngjarjet e tanishme dhe veprimet, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

**3. Politikat kryesore kontabël**

Politikat e kontabilitetit të përshkruara më poshtë janë aplikuar gjatë gjithë periudhës në këto pasqyra financiare, përpos atyre të shpjeguara në notën 3. c).

**a) Valuta funksionale dhe e prezantimit**
Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në euro ("EUR"), e cila është edhe valutë funksionale dhe legale në Kosovë.

**b) Transaksionet në valutë të huaj**

Transaksionet në valuta të huaja përkthehen në valutën funksionale me kursin e këmbimit të asaj dite.
Pasuria monetare dhe detyrimet të denominuara në valuta të jashtme në datën e raportimit po ashtu përkthehen në valutën funksionale me normën e këmbimit në datën e bilancit të gjendjes.
Humbja ose fitimi nga transaksionet me valuta është diferenca në mes kostos së amortizuar të valutës funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për normën efektive të interesit dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos të amortizimit në valutën funksionale të përkthyer me normën e këmbimit në fund të periudhës. Zërat jo-monetar që janë denominuar në valuta të huaja që maten me vlerën e tyre të tregut, janë përkthyer në valutën funksionale me normat e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e tregut. Diferencat e valutave të jashtme që lindin nga konversioni njihet si humbje ose fitim.

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### c) Interesi

Të hyrat dhe shpenzimet e interesit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma saktësisht që i zbret pagesat në kesh të parashikuara në të ardhmen dhe arkëtimet gjatë jetë gjatësisë së parashikuar te pasurisë ose detyrimit (ose, nëse është e përshtatshme, në një periudhë më të shkurtër) të vlerës së bartur të pasurisë ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit llogaritet ne vlerën fillestare te pasurisë dhe detyrimit financiar dhe nuk korrigjohet me pas.
Kalkulimi i normës efektive të interesit përfshin të gjitha tarifat të paguara apo pranuara, koston e transaksionit dhe zbritjet apo premitë që janë pjesë përbërse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që janë të lidhura me blerjen, lëshimin/dhënien ose shitjen e pasurive ose detyrimeve financiare.Të hyrat dhe shpenzimet e interesit të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përshijnë interesin e pasurive dhe detyrimeve me koston e zhvlerësuar në baza të normës efektive të interesit.

#### Ndryshimet ne politikat kontabël

Në gusht të vitit 2008 banka miratoj një politik të re të kontabilitetit për regjistrimin e të hyrave nga tarifat e aktiviteteve të huazimit. Tarifat që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit tek pasuria apo detyrimet financiare janë të përfshira në matjen e normës efektive të interesit (shih politikën e kontabilitetit d).

Gabimet janë paraqitur në pasqyrat financiare para gushtit 2008 si pasoj e regjistrimit të hyrave nga tarifat e huazimit të cilat janë regjistruar kur paraja është pranuar. Gabimet nuk janë korrigjuar në mënyrë retrospektive dhe krahasimet nuk janë rivendosur.

#### d) Tarifat dhe komisionet

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një pasuria ose obligimet financiare, janë të përfshira në matjen e normës efektive të interesit.
Të hyrat tjera nga tarifat dhe komisionet, duke përfshirë tarifat për mirëmbajtjen e llogarive, komisionet e shitjeve, tarifat e depozitave, janë të njohura ashtu siç kryhen shërbimet përkatëse.
Shpenzimet tjera nga tarifat dhe komisionet lidhen kryesisht me tarifat për transaksionet dhe shërbimet, të cilat janë të shpenzuara ashtu siç shërbimet janë pranuar.

#### e) Pagesat për lizingun operacionale

Pagesat e bëra për lizingun operacinale janë të njohura si humbje apo fitim duke përdorur metodën drejt-vizore përgjatë afatit të maturimit të lizingut. Rritjet e pranuara, janë të njohura si pjesë integrale e totalit të shpenzimeve për lizingun operacionale, përgjatë jetë gjatësisë së lizingut.

#### f) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në kohën kur ndodhin.

**3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)**

**g) Tatimi**

Tatimi është ofruar në pasqyrat financiare në përputhje me rregulloren mbi tatimet e cila është në fuqi. Shpenzimet e tatimit në të hyra përbehet nga tatimi aktual dhe ai i shtyrë. Shpenzimet e tatimit në të ardhura është i njohur në pasqyrën e të ardhurave përveç për pjesën që ai lidhet me pjesë që janë të njohura direkt në ekuitet, në të cilin rast ai është njohur në ekuitet.
Tatimi aktual është tatimi i pagueshëm i pritur mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normën e tatimit të miratuara ose substancialisht të miratuara në datë të bilancit të gjendjes, dhe të gjitha rregullimet e tatimit mbi të ardhurat në lidhje me vitet e kaluara.
Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit të gjendjes, duke ofruar diferencat e përkohshme në mes të vlerës së bartur të pasurive dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumat e përdoruara për qëllime të tatimit. Tatimi i shtyrë nuk është i njohur për diferencat e përkohshme si ne vijim: njohja fillestare e "goodwill-it", njohja fillestare e pasurive dhe detyrimeve nga transaksioni i cili nuk është kombinim i biznesit dhe i cili nuk ndikon as në profitin kontabël dhe as atë sipas tatimit, dhe diferencat e lidhura me investimet në degët, deri në masën sa ato është e mundshme të mos kthehen prapa në një të ardhme të parashikueshme. Tatimi i shtyrë është matur me norma të tatimit të cilat pritet se do të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato të kthehen prapa, duke u bazuar në ligjet të cilat janë aprovuar ose janë aprovuar substancialisht ne datën e raportimit.
Tatimi i shtyrë në pasuri është i njohur vetëm në masën që është e mundshme që fitimet e tatueshme e të ardhmen do të jenë në dispozicion kundruall të cilave pasuri do të japin dobi. Tatimi I shtyrë në pasuri rishikohet në çdo datë të raportimit dhe reduktohet në masën sa më nuk është e mundshme që përfitimet e tatimit përkatës do të realizohen.
Tatimi shtesë mbi të ardhurat që lind nga shpërndarja e dividentes është i njohur në të njëjtën kohë me njohjen e detyrimit për të paguar dividentat përkatëse.

**h) Rezerva e detyrueshme e likuiditetit**

Në përputhje me BQK rregulloret dhe rregullat, banka duhet të përmbush kërkesën për minimumin mesatar të likuiditetit. Kërkesat për likuiditetin kalkulohen në bazë mujore si 10% të bazës së depozitave, të përcaktuar si mesatare e totalit të detyrimeve ndaj depozitave (për 2008, depozitat më pak se një vit maturitet) në pjesën jobankare-publike në euro dhe në valutat tjera përgjatë ditëve të punës së periudhës së mirëmbajtjes. Shpenzimet tjera nga tarifat dhe komisionet lidhen kryesisht me tarifat për transaksionet dhe shërbimet, të cilat janë të shpenzuara ashtu siç shërbimet janë pranuar.
Pasuria me të cilat banka i përmbush kërkesat e saja të likuiditetit, janë depozitat me BQK-n dhe 50% e ekuivalenteve të parasë të denominuar në valuta të gatshme konvertibile. Depozitat me bankën qendrore nuk duhet të jenë më të ulëta se 5% e bazës së aplikuar të depozitave.
Për shkak se mjetet likuide nuk janë në dispozicion për financimin e operacioneve të përditshme të bankës, ato nuk janë të përfshirë paraja dhe ekuivalentet e parasë për qëllime të rrjedhës së parasë.

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

**i) Pasuritë dhe detyrimet financiare**

*(i) Njohja*

Banka e bën njohjen fillestare të kredive, avancave dhe depozitave në datën në të cilën ato lindin. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet tjera janë të njohura në datën e tregtimit të tyre në të cilën banka bëhet palë e obliguar ndaj dispozitave kontraktuale për instrumentin përkatës.

**(ii) Çregjistrimi**

Banka bënë çregjistrimin (mos njehë) e pasurive financiare kur përfundojnë të drejtat nga kontrata mbi rrjedhat e parasë nga pasuria financiare, ose kur ajo transferon të drejtat nga kontrata për të pranuar rrjedhat e parasë nga pasuria financiare, në një transaksion ku në mënyre thelbësore transferohen të gjitha rreziqet dhe shpërblimet që rrjedhin nga pronësia mbi pasurinë financiare. Ndonjë interes në pasurinë financiare të transferuar që krijohet ose që mbahet nga banka është i njohur ndaras si pasuri ose detyrim.
Banka bënë çregjistrimin e detyrimit financiar kur obligimet kontraktuale janë të shkarkuara, shlyera, ose të skaduar.
Banka hyn në transaksione me anë të cilave ajo transferon pasuritë e njohura në bilancin e gjendjes, por e mban ose tërë rreziqet dhe shpërblimet e pasurisë të transferuar , ose një pjese të tyre. Nëse mbahen të gjitha rreziqet dhe shpërblimet ose ato thelbësore, atëherë pasuritë nuk janë të çregjistruara nga bilanci i gjendjes. Transferimi i pasurive me mbajtjen e të gjitha rreziqeve dhe shpërblimeve ose të atyre thelbësore përfshin, për shembull: huat e letrave me vlerë dhe marrëveshjet e riblerjes. Kur pasuritë janë shitur palëve të treta në harmoni me normat totale kthimit swap në transferimin e pasurive, transaksionet është llogaritur si transaksion I sigurtë dhe i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.
Në transaksionet ku banka as nuk mban as nuk transferon të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së pasurive financiare ose ato thelbësore, ajo i çregjistron pasuritë nëse kontrolli mbi të është i humbur.
Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transfer janë të njohura ndaras si pasuritë dhe detyrime përkatëse. Në transferet ku kontrolli mbi pasuritë është mbajtur, banka vazhdon të njoh pasurinë deri në masën e vazhdimit të involvimet të saj, të determinuar nga masa me të cilën ajo është e ekspozuar në ndryshimet në vlerën e pasurisë të transferuar banka po ashtu i çregjistron disa pasuri kur ajo i shlyen balancat të cilat u takojnë pasurive që konsiderohet që janë të pa mbledhshëm.

**(iii) Matja e kostos së amortizuar**

Matja e kostos së amortizuar të pasurive dhe detyrimit financiar është shuma në të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare zbritur ri-pagesat e principalit, shtuar ose zbritur për komulativin e amortizimit duke përdorur metodën e normës efektive të interesit të diferencave në mes shumës fillestare të njohur dhe shumës së maturuar, zbritur për demet.



**(iv) Matja e vlerës së tregut**

Përcaktimi i vlerës së tregut të pasurive dhe detyrimeve financiare të bazuara në çmimet e kuotuara të tregut ose në kuotimet e çmimeve nga dileret për instrumentet financiare të tregtuar në tregjet aktive.
Për të gjitha instrumentet tjera financiare vlera e tregut paracaktohet duke përdorur metodat e vlerësimit. Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikat e vlerës së tashme neto, metodën e diskontimit të parasë, krahasimin e instrumenteve financiare të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime të vrojtuar në treg, dhe modelet e vlerësimit.

**3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)**

**i) Pasuria dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

**(iv) Matja e vlerës së tregut (vazhdim)**

Banka përdor modele te vlerësimit te përdorura gjerësisht për te përcaktuar vlerën e tregut e instrumenteve financiare te zakonshme dhe te atyre me te thjeshta, si opsionet dhe normat e interesit dhe swap-këmbimet. Për këto instrumente financiare, te dhënat e futura ne model janë te vrojtueshme ne treg.

**(v) Identifikimi dhe matja e provizionimit**

Provizioni për rrezikun e kredisë për kreditë e shlyera behët nëse ekziston një evidencë objektive që banka nuk do të jetë në gjendje të mbledh bazuar në kushtet e kontaktuara. Shuma e provizionit është e përcaktuar në bazë të Rregulloreve të BQK-së e rregulluar nga shumat e mbuluara nga garancionet dhe kolaterali. Provizioni për kreditë me rrezik-të shlyera gjithashtu mbulon humbjet e përgjithshme për të cilat ekziston një evidencë objektive, që humbje të mundshme janë prezente në elemente të portofolios së kredisë në datën e bilancit të gjendjes.

Këto janë vlerësuar në bazë të modeleve të humbjeve historike në çdo element dhe të vlerësimit kreditor të caktuar ndaj kredi marrësve dhe reflekton ambientin e tanishëm ekonomik në të cilin kredi marrësi vepron. Kur një kredi konsiderohet e pa-arkëtueshme, ajo shlyhet me provizionet për shlyerjen e kredive. Kredi të tilla shlyhen pasi të gjitha procedurat e domosdoshme janë ndërmarre dhe shuma e humbjeve është përcaktuar.
Mbulime të mëvonshme të shumave të kredisë të cilat paraprakisht janë shlyer kreditohen në pasqyrën e të ardhurave. Nëse shuma e provizionit për kreditë e shlyera më vone zvogëlohet si pasojë e ndonjë ngjarje pas shlyerjes, atëherë zvogëlimi i provizionit kreditohet në provizionin për shlyerjen e kredive në pasqyrën e të ardhurave.

Në vazhdim kemi klasifikimin e kategorive dhe shkallët e provizioneve minimale si është caktuar nga BQK:

| KATEGORITË | NORMA E PROVIZIONIT |
|---|---|
| Nën-standarde | 20% |
| Të dyshimta | 50% |
| Humbje | 100% |

Përveç provizioneve specifike të kërkuara ndaj ekspozimit të klasifikuar, banka bënë provizion të përgjithshëm ndaj portfolios të mbetura jo të klasifikuara ose pjesë të portofolios. Provizioni i përgjithshëm, bëhet bazuar në përvojën e dokumentuar historike, e rregulluar për kushtet e tanishme dhe të mundshme të tregut.



**j) Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë paratë e letrës dhe metalike, balancat jo të kufizuara që mbahen në banka qendrore dhe pasuri me likuiditet të lartë me maturitet prej më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt e rreziqeve jo të rëndësishme të ndryshimit në vlerën e tyre të tregut, dhe përdoren nga banka në menaxhimin e përkushtimeve të saj afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentet e parasë barten në koston e amortizuar, në bilancin e gjendjes .

**3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)**

**k) Kredi ndaj konsumatorëve**

Kreditë dhe avancet janë pasuri financiare jo derivateve me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuara në një treg aktive dhe të cilat banka nuk tenton ti shet menjëherë ose në një të ardhme më të afërt.
Kur banka blen një pasuri financiare, dhe njëjte kur hyn në marrëveshje për të shitur pasurinë (ose një pasuri shumë të ngjashëm) në një çmim fiks në një datë të ardhme("reverse repo"), marrëveshja vlerësohet si kredi ose avance, dhe pasuria e cekur nuk njihet në pasqyrat financiare të bankës.
Kreditë dhe avance fillimisht maten me vlerën e tregut shtuar kostot direkte rritëse të transaksioneve, dhe më vonë maten me koston e amortizuar duke përdorur normën efektive të interesit.

**1) Patundshmëritë dhe paisjet**

Patundshmëritë dhe paisjet janë vlerësuar në bazë të kostos duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe provizionimin nga heqjet prej përdorimit, aty ku kërkohet. Kosto përfshinë shpenzimet që janë direkt të inkuadruar në blerjen e pasurive. Aty ku njësi të pasurisë ose paisjeve kanë vlerë të ndryshme të jetëgjatësisë, ato paraqiten ndaras (komponentët më të mëdha) të patundshmërive dhe pajisjeve.
Kosto e zëvendësimit të një pjese të pasurisë ose paisjeve njihet në vlerën bartëse të njësisë, nëse pritet që të mira të ardhshme do të rrjedhin në bankë dhe nëse kosto e tyre mund matet në mënyre të besueshme. Shpenzimet ditore për mirëmbajtjen e pasurisë dhe paisjeve njihen në fitim ose humbje.
Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave me metodën drejtë-vizore përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të pasurisë dhe paisjeve. Pasuritë me qira zhvlerësohen për një periudhë më të shkurtë bazuar në marrëveshjen për qira dhe jetëgjatësisë së tyre.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasuese është si më poshtë:

| KATEGORITË E PASURIVE | NORMAT E ZHVLERËSIMIT TË PËRDORURA |
|---|---|
| Investimet në objektet me qira | 5 vite |
| Paisjet kompjuterike | 5 vite |
| Veturat | 5 vite |
| Paisjet e tjera | 5 vite |

**m) Pasuritë e paprekshme**

Softueri i blerë nga banka është vlerësuar në kosto, zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e zhvlerësimit. Shpenzimet e më pasme të softuerit kapitalizohen vetëm atëherë kur t'i rritet vlera ekonomike e ardhshme për pasuritë specifike me të cilat lidhet. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në bazë të ndodhjes.
Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën drejtë-vizore duke u bazuar në vlerësimin e jetëgjatësisë së softuerit, nga data që është futur në përdorim. Jetëgjatësia e softuerit konsiderohet të jetë pesë vite.

**3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)**

**n) Humbja e vlerës së pasurive**

Shuma e bartur e pasurive jo financiare të bankës, tjetër nga tatimi I shtyrë në pasuri, janë rishikuar nv çdo datë të raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë shenjë për shlyerje/provizioni të tyre. Nëse ndonjë shenjë paraqitet atëherë shuma e mbetur e pasurisë parashikohet.

Një humbje nga dëmtimi njihet nëse shuma e bartur e një pasurie e kalon shumën e mbetur humbjet nga dëmtimi njihen në pasqyrën e tv ardhurave dhe shpenzimeve.

Shuma e mbetur e një pasurie është më e madhe se vlera në libra dhe vlera e tregut e zvogëluar për kostot e shitjes. Për të caktuar vlerën në libra, rrjedhat e parashikuara të ardhshme të parasë diskontohen në vlerën e tashme duke përdorur normën e zbritjes para taksave që reflekton vlerësimin aktual në treg të vlerës së parasë në kohe dhe rrezikun specifik për pasurin përkatës. Humbjet nga dëmtimet të njohura në periudhat paraprake janë vlerësuar në çdo datë të raportimit për ndonjë shenjë e cila tregon që humbja është ulur apo nuk ekziston fare.

Një humbje nga dëmtimi kthehet mbrapa nëse ndodhë ndonjë ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar shumën e riparuar (mbuluar). Një humbje nga dëmtimi kthehet mbrapa vetëm në atë masë që shuma e bartur e një pasurie nuk e kalon shumën e mbartur që është llogaritur, shuma neto e zhvlerësimit dhe amortizimit, nëse nuk janë njohur humbjet nga dëmtimi.

**o) Depozitat dhe detyrimet tjera financiare**

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë pjesë e burimeve të financimit të borxheve të bankës.
Kur banka shet një aset financiar dhe njejtë kur ajo hyn në marrëveshje të riblerjes (repo) së ndonjë pasurie (ose të pasurisë të njejtë) në një datë të ardhme me çmim fiks, marrëveshja merret si depozitë, dhe pasuria vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të bankës.
Banka i klasifikon instrumentet e kapitalit si detyrime financiare ose instrumente ekuiteti në pajtim me përmbajtjen e kushteve të kontratës së këtyre instrumenteve.
Depozitat dhe detyrimet tjera financiare fillimisht maten me vlerën e tregut plus kostot e blerjes dhe me pas matet me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

**p) Provizionet**

Një provizion njihet nëse si pasojë e një ngjarje në të kaluarën, banka aktualisht ka një obligim ligjor ose të tërthorte, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur qe do të kërkohen rrjedha dalëse të përfitimeve ekonomike për të shlyer obligimin. Provizionet janë llogaritur duke e diskontuar rrjedhën e ardhshme të pritur të parasë me normën e para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe nëse duhet rreziqet specifike të detyrimeve.



**q) Zotimet jashtë bilancore**

Në rrjedhën e zakonshme të biznesit banka hynë në zotimet e lidhura me kredi që janë të regjistruara në konto jashtë bilancore ku fillimisht përfshihen garancionet, letrat kreditore dhe kreditë e zotuara dhe të pa tërhequra. Këto angazhime financiare regjistrohen në bilancin e gjendjes të bankës vetëm kur këto bëhen të pagueshme. Provizionet për angazhimet dhe rastet e detyrimet kontingjente të humbjeve bëhen sipas rregulloreve të BQK-së.

## 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

### r) Përfitimet/dobitë e punëtorëve

*(i) Plani i definuar i kontributeve pensionale*

Banka obligon punëtorët e saj për kontributet për sigurim social të cilat ofrojnë përfitime pensionale për punëtorë me rastin e pensionimit të tyre. Autoritet lokale janë përgjegjëse për caktimin e minimumit të shumës së lejuar për pensionet në Kosovë bazuar në një plan të definuar të kontributeve pensionale. Kontributet e bankës për pensione hyjnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur të ndodhin.
Në vitit 2008 banka vullnetarisht filloj të kontribuoi nga 10 euro për muaj për secilin punëtorë tek skema Fondin Slloven të Pensioneve. Kontributet e bankës për pensione hyjnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur të ndodhin.

*(ii)Përfitimet afatshkurtra*

Obligimet afatshkurtra për përfitimet e punëtorëve janë llogaritur në baza të padiskontuara (pazbritura) dhe shpenzohen kur shërbimi përkatës të jetë ofruar.
Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet si bonus afatshkurtër I parasë ose planet e ndarjes së fitimit, nëse banka ka ndonjë detyrim ligjor ose të tërthortë për të paguar ketë shumë si rezultat shërbimeve të ofruara në të kaluarën nga punëtorët dhe detyrimi mund të matet besueshëm.

### s) Shifrat krahasuese

Disa shifra krahasuese në notën 17 shpenzimet tjera operacionale, janë riklasifikuar në mënyre që të përshtaten me prezantimet e vitit aktual.

## 4. Paraja e gatshme në dorë dhe në banka

Paraja e gatshme në dorë dhe në banka përbëhet prej:

| | 2008 | 2007 |
|---|---|---|
| Paraja e gatshme në dorë | 2,888 | 3,782 |
| Llogaritë rrjedhëse me bankat tjera | - | 685 |
| Depozitat overnight (njëditore) | 23,143 | 14,784 |
| **Gjithsej paraja e gatshme në dorë dhe në banka** | **26,031** | **19,251** |



Overnight (njëditore) depozitat të mbajtura në bankat jo-vendore marrin interes diku nga euro 3.30% deri 3.74% (2006:euro 3.61% pa).

### 5. Balancat me Bankën Qendrore

Balancat me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK") paraqet rezerva të obligueshme. Shuma minimale e obligueshme e rezervës e kërkuar nga rregulloret e BQK-së, është 10% e mesatares mujore të depozitave të klientëve (gjatë vitit 2008, depozitat me afat maturimi më të vogël se një vit). Balanca e rezervës së obligueshme minimale ka sjellur interes vjetor në 2008 në mes 1.25% dhe 3.25% p.a. (2007: 3.00%), derisa shuma që tejkalon minimumin e rezervës së likuiditetit nuk fiton interes.

### 6. Kreditë për klientët

Kreditë për klientët janë të përbëra nga:

| KREDITË | 2008 | 2007 |
|---|---|---|
| Kreditë afatshkurtra | 18,480 | 4,860 |
| Kreditë afatgjata | 24,499 | 20,609 |
| Mbitërheqjet | 10,987 | 6,259 |
| | **53,966** | **31,728** |
| Interesi aktual | 312 | 247 |
| | **54,278** | **31,975** |
| Provizionimet për kreditë e këqija | (947) | (959) |
| **Kreditë për klientë** | **53,331** | **31,016** |

Mbitërheqjet paraqesin kredi afatshkurtra që janë të siguruara me kolateral.

Kreditë afatgjata kanë afat të maturimit nga 1 deri në 5 vite. Gjatë vitit që ka përfunduar më 31 dhjetor 2008 banka i ka ngarkuar me interes klientët e saj nga 9% p.a. deri në 22 % p.a. (2007: 11% deri ne 16% p.a.)

**Lëvizjet në provizionime të kredive të këqija janë si më poshtë:**

| | 2008 | 2007 |
|---|---|---|
| Provizionimi për kreditë e këqija më 1 janar | 959 | 1,005 |
| Heqjet gjatë vitit për shkak të pamundësisë së marrjes | (992) | (1,735) |
| Shpenzimet e bëra gjatë periudhës | 980 | 1,689 |
| **Provizionimi për kreditë e këqija më 31 dhjetor** | **947** | **959** |

Një analizë industriale e portfolios së kredive të dhëna klientëve, bizneseve para provizionimeve dhe interesit akrual si më poshtë:

| SEKTORI INDUSTRIAL | 2008 | 2008 | 2007 | 2007 |
|---|---|---|---|---|
| | | % | | % |
| Shitjet me shumicë | 21,998 | 41 | 17,323 | 55 |
| Prodhuese | 1,851 | 3 | 1,169 | 4 |
| Konsumuese | 11,288 | 21 | 4,193 | 13 |
| Shërbime | 5,155 | 10 | 3,357 | 11 |
| Hotele dhe restorante | 801 | 1 | 281 | 1 |
| Agrikulturë | 512 | 1 | 136 | - |
| Konstruksion | 12,278 | 23 | 5,128 | 16 |
| Të tjera | 83 | - | 141 | - |
| | **53,966** | **100** | **31,728** | **100** |

### 6. Kredit për klientë

Më 31 dhjetor 2008, dhjetë huamarrësit më të mëdhenj të bankës përfshijnë 27% (2007: 35%) nga tërë portfolio e kredive. Huamarrësit nga palët e ndërlidhura përfshijnë 11% (2007: 29%) nga e tërë portfolio kreditore.
Një analizë e balancave neto të kredive të dhëna klientëve (përveç mbitërheqjeve) si me 31 dhjetor 2008 janë:

| KATEGORIA E KREDISË | Principali i mbetur dhe interesi aktual | Provizinimi për humbjet | Neto gjendja |
|---|---|---|---|
| Të përgjithshme (të rregullta) | 37,261 | 41 | 37,220 |
| Standarde | 11,834 | 23 | 11,811 |
| Vrojtuese | 3,492 | 92 | 3,400 |
| Nën-standarde | 586 | 122 | 464 |
| Dyshimta | 1,069 | 633 | 436 |
| Humbje | 36 | 36 | - |
| **Neto kreditë e dhëna klientëve** | **54,278** | **947** | **53,331** |

Një analizë e balancave neto të kredive të dhëna klientëve (përveç mbitërheqjeve) si me 31 dhjetor 2007 janë:

| KATEGORIA E KREDISË | Principali i mbetur dhe interesi aktual | Provizinimi për humbjet | Neto gjendja |
|---|---|---|---|
| Të përgjithshme (të rregullta) | 6,261 | - | 6,261 |
| Standarde | 17,351 | 104 | 17,247 |
| Vrojtuese | 6,932 | 89 | 6,843 |
| Nën-standarde | 256 | 49 | 207 |
| Dyshimta | 954 | 473 | 481 |
| Humbje | 221 | 221 | - |
| Provizionimi për garancionet | - | 23 | (23) |
| **Neto kreditë e dhëna klientëve** | **31,975** | **959** | **31,016** |

(shumat në '000 euro, përveç nëse cekan ndryshe)

### 7. Patundshmëri dhe paisjet

| | Ndërtesat | Investimet në objektet e marra me qira | Inventari dhe paisjet | Kompjuterët dhe paisjet përkatëset | Veturat | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kosto:** | | | | | | |
| **Më 1 janar 2007** | **460** | **243** | **906** | **550** | **130** | **2,289** |
| Shtesat gjatë vitit | - | 24 | 155 | 37 | 22 | 238 |
| Heqja nga përdorimi | - | - | (4) | (17) | - | (21) |
| **Më 1 janar 2008** | **460** | **267** | **1,057** | **570** | **152** | **2,506** |
| Shtesat gjatë vitit | - | 192 | 328 | 61 | 120 | 701 |
| Riklasifikime | - | - | (25) | - | - | (25) |
| Heqja nga përdorimi | - | - | (28) | (8) | - | (36) |
| **Më 31 dhjetor 2008** | **460** | **459** | **1,332** | **623** | **272** | **3,146** |
| **Zhvlerësimi i akumuluar:** | | | | | | |
| **Më 1 janar 2007** | 17 | 194 | 342 | 237 | 35 | 825 |
| Shpenzimet për vitin | 23 | 27 | 141 | 77 | 23 | 291 |
| Heqja nga përdorimi | - | - | (2) | (9) | - | (11) |
| Më 1 janar 2008 | 40 | 221 | 481 | 305 | 58 | 1,105 |
| Shpenzimet për vitin | 23 | 50 | 185 | 87 | 31 | 376 |
| Heqja nga përdorimi | - | - | (17) | (6) | - | (23) |
| **Më 31 dhjetor 2008** | **63** | **271** | **649** | **386** | **89** | **1,458** |
| **Vlera neto:** | | | | | | |
| **Më 1 janar 2007** | **443** | **49** | **564** | **313** | **95** | **1,464** |
| **Më 31 dhjetor 2007** | **420** | **46** | **576** | **265** | **94** | **1,401** |
| **Më 31 dhjetor 2008** | **397** | **188** | **683** | **237** | **183** | **1,688** |

Ndërtesat paraqesin pasurinë e cila më parë ka qenë e lënë peng nga huamarrësi si kolateral, në mënyrë që të sigurojë dy kredi të cilat i ka lejuar banka. Pronësia e kësaj pasurie është transferuar te banka gjatë viti 2006, sepse huamarrësi nuk ka qenë në gjendje ta kthej kredinë e marrë. Ne 2007 menaxhmenti ka vendosur qe te përdor ketë pasuri për nevoja të aktiviteteve të bankës.

**8. Pasuria e paprekshme**

| KOSTO: | Softvueri kompjuterik (në euro 000) |
|---|---|
| **Me 1 janar 2007** | **234** |
| Shtesat | 2 |
| Shlyerjet | (5) |
| **Me 31 dhjetor 2007** | **231** |
| Riklasifikimet | 25 |
| **Me 31 dhjetor 2008** | **256** |
| | |
| **Amortizimi i akulumuar:** | |
| **Me 1 janar 2007** | **126** |
| Shpenzimet për vitin | 18 |
| **Me 31 dhjetor 2007** | **144** |
| Shpenzimet për vitin | 29 |
| **Me 31 dhjetor 2008** | **173** |
| **Vlera neto:** | |
| **Më 1 janar 2007** | **108** |
| **Më 31 dhjetor 2007** | **87** |
| **Më 31 dhjetor 2008** | **83** |

**9. Të tjera**

| | 2008 | 2007 |
|---|---|---|
| Interesi i paguar në avanc | 514 | - |
| Tatimi në interesin e paguar në avanc | 129 | - |
| Parapagimet | 450 | 120 |
| Të tjerat | 52 | 375 |
| | **1,145** | **495** |

**10. Të hyrat e shtyra**

Të hyrat e shtyra përbëhen nga të hyrat e shtyra nga komisionet për kreditë. Deri në fund të muajit korrik 2008, banka ka njohur të hyrat nga komisionet në momentin e arkëtimit të tyre, ndërsa nga muaji gusht 2008, ajo ka filluar që të shtyjë të hyrat dhe ti njoh ato të hyra përgjatë periudhës së maturimit të kredisë. Totali I të hyrave të shtyra nga komisionet me datë 31 dhjetor 2008 është 155,709 euro (2007: zero). Shih politiken kontabël 3.c.

## 11. Depozitat e klientëve

| | 2008 | 2007 |
|---|---|---|
| **Llogaritë rrjedhëse** | | |
| Llogaritë rrjedhëse në euro | 19,468 | 11,428 |
| Llogaritë rrjedhëse ne valutën e huaj | 186 | - |
| Llogaritë e kursimit | 4,167 | - |
| Llogaritë e bllokuara | 617 | - |
| | **24,438** | **11,428** |
| **Depozitat e afatizuara:** | | |
| Në euro | 46,435 | 31,891 |
| Në valuta të huaja | 1,726 | 1,186 |
| Interesi aktual | 1,072 | 503 |
| **Nën-gjithsej** | **49,233** | **33,580** |
| **Gjithsej** | **73,671** | **45,008** |

Llogaritë rrjedhëse nuk sjellin interes.
Për depozitat e afatizuara, norma efektive e interesit gjatë vitit 2008 ishte:

| 1 muaj | 3 muaj | 6 muaj | 1 vit | 18 muaj | 2 vite | 3 vite | 5 vite |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| % | % | % | % | % | % | % | % |
| 2.5 | 2.7 - 3 | 3.5 - 4 | 4.5 - 4.7 | 4.8 | 5 - 5.2 | 5.3 - 5.4 | 6 – 6.2 |

Për depozitat e afatizuara, norma efektive e interesit gjatë vitit 2006 ishte:

| 1 muaj | 3 muaj | 6 muaj | 1 vit | 18 muaj | 2 vite | 3 vite | 5 vite |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| % | % | % | % | % | % | % | % |
| 2.3 - 2.5 | 2.5 - 2.7 | 3.0 - 3.5 | 4.0 - 4.5 | 4.2 - 4.8 | 4.5 – 5.0 | 4.6 - 5.3 | 5.0 - 6.0 |

Në lidhje me normat e sipër cekura, shumica e depozitave të afatizuara të lidhura me mbulesë në kesh janë të ngarkuara me norma të interesit nën këto norma.

Norma e interesave vjetore të aplikuara nga banka gjatë vitit 2008 dhe 2007 për secilën periudhë të maturimit të depozitave është si më poshtë:

| LLOJI I KLIENTIT | Deri në 30 ditë | 31 deri 90 ditë | 91 deri 180 ditë | 181 deri 270 ditë | 271 ditë dhe më shumë |
|---|---|---|---|---|---|
| **2008:** | | | | | |
| Kompanitë | 1.80% | 2.80% | 3.01% | 3.90% | 4.95% |
| Individët | 1.80% | 2.80% | 3.01% | 3.90% | 4.95% |
| **2007:** | | | | | |
| Kompanitë | 1.81% | 2.50% | 2.94% | 3.17% | 4.52% |
| Individët | 1.81% | 2.50% | 2.94% | 3.17% | 4.52% |

### 12. Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga:

| | 31 dhjetor 2008 | 31 dhjetor 2007 |
|---|---|---|
| Tatimet e tjera të pagueshme | 35 | 58 |
| Pensionet, asistencat sociale | 42 | 26 |
| Shpenzimet aktuale | 50 | 45 |
| **Gjithsej** | **127** | **129** |

### 13. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i autorizuar dhe paguar përbëhet nga 42,046 aksionet e rregullta me vlerë nominale prej 256 euro si me 31 dhjetor 2008, në shumën prej 10,763,776 euro, (31 dhjetor 2007: 41,976 aksione të rregullta me vlerë nominale prej 256 euro për secilën në shumë prej 10,745,856).
Në përputhshmëri me Rregullin Nr. XXI për "Rritjen Minimale të Kapitalit të Bankës" autorizuar nën Seksionin 5 të Rregullës Nr.1999 / 21 lëshuar nga AQBK, minimumi i kapitalit të bankës për të operuar në Kosovë duhet të jetë 5 milionë euro.

Duke u bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të Bankës, i cili është aprovuar nga asambleja e përgjithshme e aksionareve e mbajtur me datë 30 prill 2008, balanca në fitimin e mbajtur prej 18,374 euro si me 31 dhjetor 2007, I është shpërnda aksionarëve në forme të aksioneve të reja.

(shumat në '000 euro, përveç nëse ceken ndryshe)

**Një përmbledhje e aksionarëve të bankës është si vijon:**

| AKSIONARI | Si me 31 dhjetor 2008<br>Përqindja e pronësisë | Si me 31 dhjetor 2008<br>(në euro 000') | Si me 31 dhjetor 2007<br>Përqindja e pronësisë | Si me 31 dhjetor 2007<br>(në euro 000') |
|---|---|---|---|---|
| Behgjet Pacolli | 46.17 | 4,970 | 46.17 | 4,961 |
| Hasan Hajdari | 7.02 | 756 | 15.77 | 1,695 |
| Raif Rexhepi | 22.32 | 2,402 | 13.48 | 1,449 |
| Xhabir Kajtazi | 7.92 | 853 | 7.92 | 851 |
| Zyhra Hajdari | 4.78 | 515 | 4.78 | 514 |
| Ismet Gjoshi | 4.07 | 438 | 4.07 | 438 |
| Afrim Pacolli | 3.06 | 329 | 3.06 | 329 |
| Selim Pacolli | 1.05 | 113 | 1.05 | 113 |
| Elkos | 0.98 | 105 | 0.97 | 104 |
| Të tjerët me pak se 1% | 2.63 | 283 | 2.73 | 292 |
| | **100** | **10,764** | **100** | **10,746** |

Tabela më poshtë tregon lëvizjet në kapitalin aksionar gjatë vitit

| | 2008<br>në'000 euro | 2007<br>në'000 euro |
|---|---|---|
